

**KONTRATË SHITBLERJE E PASURISË LUAJTSHME
(SHITJE KUOTASH)**

Sot më datë **22/09/2019** (dymijë e nëntëmbëdhjetë) lidhet kjo kontratë shitje mes palëve si mëposhtë:

PALA SHITËSE:

SHEFQET BILLA, atësia ARIF, i lindur në Vilë, Kukës, më datë 11.01.1952 dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar i identifikuar me Letërnjoftimin me numër personal F20111018V, me datë lëshimi 23.11.2009.

(në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si "Shitesi");

JETMIR BILLA, atësia SHEFQET, i lindur në Vilë, Kukës, më datë 19.05.1983 dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar i identifikuar me Letërnjoftimin me numër personal I30519198O, me datë lëshimi 24.03.2010.

(në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si "Shitesi");

IDEAL BILLA, atësia SHEFQET, i lindur në Vilë, Kukës, më datë 16.08.1979 dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar i identifikuar me Letërnjoftimin me numër personal H90816120C, me datë lëshimi 10.03.2009.

(në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si "Shitesi");

ARJETA BILLA, atësia SHEFQET, i lindur në Vilë, Kukës, më datë 16.10.1990 dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar i identifikuar me Letërnjoftimin me numër personal J06016043P, me datë lëshimi 05.06.2019.

(në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si "Shitesi");

PALA BLERËSE:

ARIF BILLA, atësia SHEFQET i lindur në Vilë, Kukës, më datë 02.04.1987 dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar i identifikuar me Letërnjoftimin me numër personal I70402078M, me datë lëshimi 25.03.2019.


(në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si "Blerësi");

Në vijim e për efekt të kësaj Kontrate, Shitësit dhe Blerësi do të referohen veçmas si Palë/a dhe së bashku si Palë/t.

MEQËNËSE:

Shitësit i kanë njoftuar Blerësit ofertën e tyre për shitjen e 74.5% (shtatëdhjetë e katër pikë pesë përqind) të kapitalit të Shoqërisë që ata zotërojnë dhe Blerësi ka pranuar të blejë pjesëmarrjen e ofruar nga Shitësit në Shoqëri;

Shoqëria "BILLA HOME" Sh.p.k. (në vijim "Shoqëria") është një shoqëri tregtare me përgjegjësi te kufizuar, e krijuar e që funksionon në përputhje me legjislacionin shqiptar, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me Numër Unik Identifikimi NUIS **L82113027A**, me kapital themeltar prej 100,000 (njëqind mijë) lekë të ndara në 5 kuota dhe sikurse rezulton nga regjistrimet në Regjistrin Tregtar, Shitësi Shefqet Billa zotëron 11 kuota me



28% të pjesëmarrjes në Kapital, shitësi Jetmir Billa zotëron 1 kuotë me 15% të pjesëmarrjes në Kapital, Shitësi Ideal Billa zotëron 1 kuotë me 25.5% të pjesëmarrjes në Kapital dhe shitësi Arjeta Billa zotëron 1 kuotë me 6% të pjesëmarrjes në Kapital.

Palët kanë vendosur të lidhin këtë Kontratë sa më poshtë vijon:

Neni 1. Objekti

1.1. Nëpërmjet kësaj Kontrate Shitësi Shefqet Billa i shet Blerësit 28% (njëzetetë për qind) të kuotës së kapitalit që ai zotëron në Shoqërinë Billa Home sh.p.k. dhe Blerësi blen pjesëmarrjen e mësipërme nga Shitësi.

1.2. Nëpërmjet kësaj Kontrate Shitësi Jetmir Billa i shet Blerësit 15% (pesëmbëdhjetë për qind) të kuotës së kapitalit që ai zotëron në Shoqërinë Billa Home sh.p.k. dhe Blerësi blen pjesëmarrjen e mësipërme nga Shitësi.

1.3. Nëpërmjet kësaj Kontrate Shitësi Ideal Billa i shet Blerësit 25.5% (njëzetepesë pikë pesë për qind) të kuotës së kapitalit që ai zotëron në Shoqërinë Billa Home sh.p.k. dhe Blerësi blen pjesëmarrjen e mësipërme nga Shitësi.

1.4. Nëpërmjet kësaj Kontrate Shitësi Arjeta Billa i shet Blerësit 6% (gjashtë për qind) të kuotës së kapitalit që ai zotëron në Shoqërinë Billa Home sh.p.k. dhe Blerësi blen pjesëmarrjen e mësipërme nga Shitësi.

Neni 2. Çmimi

2.1. Çmimi i shitjes së 28% (njëzetetë për qind) kuotave të kapitalit nga ortaku SHEFQET BILLA është në vlerën 28,000 (njëzetetëmijë) lekë, e cila do të paguhet menjëherë nga blerësi **ARIF BILLA**.

2.2. Çmimi i shitjes së 15% (pesëmbëdhjetë për qind) kuotave të kapitalit nga ortaku JETMIR BILLA është në vlerën 15,000 (pesëmbëdhjetëmijë) lekë, e cila do të paguhet menjëherë nga blerësi **ARIF BILLA**.

2.3. Çmimi i shitjes së 25.5% (njëzetepesë pikë pesë për qind) kuotave të kapitalit nga ortaku IDEAL BILLA është në vlerën 25,500 (njëzetepesëmijë e pesëqind) lekë, e cila do të paguhet menjëherë nga blerësi **ARIF BILLA**.

2.4. Çmimi i shitjes së 6% (gjashtë për qind) kuotave të kapitalit nga ortaku ARJETA BILLA është në vlerën 6,000 (gjashtëmijë) lekë, e cila do të paguhet menjëherë nga blerësi **ARIF BILLA**.

Neni 3. Deklarimet dhe garancitë

3.1. Shitësi deklaron dhe vërteton se në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate zotëron pjesëmarrjen e transferuar sipas kësaj Kontrate, dhe se nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Shitësi nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave janë të Shitësit

3.2. Blerësi deklaron dhe vërteton se nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Blerësi nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave është Blerësi.



Neni 4. Transferimi i të drejtave

4.1. Pronësia mbi kuotat e Shoqërisë, objekt i kësaj Kontrate, kalon nga Shitësit te Blerësi menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate dhe regjistrimit në QKB të vendimit të Asamblesë së Shoqërisë Billa Home sh.p.k. dhe pavarësisht mënyrës së pagesës çmimit të shitjes. Kjo Kontratë nuk është dhe në asnjë rast nuk do të interpretohet si një kontratë shitje me rezervë pronësie. Kalimi i pronësisë së kuotave të Shoqërisë në favor të Blerësit do të regjistrohet menjëherë në Qendrën Kombëtare të Biznesit, pas miratimit nga asambleja e ortakëve të këtij transferimi, në përputhje me Ligjin 9901/2008, të ndryshuar dhe Ligjin 9723/2007, të ndryshuar.

4.2. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Blerësi gëzon të gjitha të drejtat për të regjistruar pronësinë mbi kuotat në Regjistrin Tregtar si dhe pranë çdo institucioni tjetër sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 5. Të ndryshme

5.1. Çdo kusht, klauzolë apo parashikim i kësaj Kontrate do të jetë i vlefshëm pavarësisht kushteve, klauzolave apo parashikimeve të tjera dhe vlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi nuk do të çenohet nga pavlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi tjetër.

5.2. Kjo Kontratë do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Ligjit 9901/2008, të ndryshuar dhe Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

5.3. Çdo konflikt që ka lindur si pasojë apo lidhet me këtë Kontratë do të zgjidhet në marrëveshje ndërmjet Palëve, në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e konflikteve është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

5.4. Kjo Kontratë hartohet në gjuhën shqipe në 6 (gjashtë) kopje origjinale.

PALET KONTRAKTUESE

Lexuar, aprovuar dhe nënshkruar nga:




PALA SHITËSE

SHEFQET BILLA

JETMIR BILLA

IDEAL BILLA

ARJETA BILLA



PALA BLERËSE

ARIF BILLA

